

PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE

TIRANE ALBANIA

RAPORTUESI I AUDITUESIT TE PAVARUR

DHE

PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE

SHPENZIMEVE TE KRYERA

GJATE FUSHATËS ZGJEDHORE PËR PERIUDHËN

21 maj 2015-21 qershor 2015

Drejtuar: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Bulevardi ``Deshmoret e Kombit`` “Pallati i Kongreseve”,Tirane

Nga: Lefteri KUSHTA

Eksperte Kontabel e Regjistruar Nr Licence 58 dt. 31.01.2000

Rr. “Don Bosko”, Pall Aurora, Tirane

TIRANE, MË 15.10. 2015

## PËRMBLEDHJE E LENDEËS

- Raporti i audiuesit të pavarur
- Shënime mbi deklaratata financiare
  - I. Të përgjithshme
  - II. Organizimi I Kontabilitetit dhe Politikat kontabile operuese
  - III. Të ardhurat
  - IV. Shpenzimet

## **RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR**

**Drejtuar: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve**

*(Bulevardi: “ Dëshmmorët e Kombit” Pallati I Kongreseve)*

**Tiranë**

**Partia Socialiste e Shqipërisë**

*( Sheshi “Austria”)*

**Tiranë**

***Të nderuar zotërinj,***

Ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar, bazuar në ligjin 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në zbatim të Vendimit të KQZ, datë 10.08.2015, si dhe Kontratën e Shërbimit nr.7709, datë 29.09.2015, kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, që fillon me datë 21.05.2015, me regjistrimin e Partisë Socialiste, në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 21.06.2015, me përfundimin e fushatës zgjedhore, të 21 qershorit të vitit 2015.

Pergatitja e ketyre pasqyrave eshte përgjegjësi e Partise Socialiste te Shqiperise e cila eshte përgjegjese per pergatitjen dhe paraqitjen ne menyre te sinqertë të këtyre pasqyrave në përputhje me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë 29.09.2004. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave.

Përgjegjësia jonë është që bazuar në auditimin e kryer, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, referencë të veçantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme se këto pasqyra nuk përmbajnë anomalji materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare, që përfshijnë : Librin e llogaritjeve të subjektit, Regjistrin e posaçëm, të miratuar si model me vendim nr.266 të KQZ-së, datë 01.06.2009 si dhe Pasqyrën e arkëtimit pagesave.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Në çmobjmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### **Opinion**

Sipas opinionit tonë, bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara, për fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste, që fillon me datë 21.05.2015 dhe mbyllet me datën 21.06.2015, janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave, konform ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”, duke dhënë **një pamje të vërtetë dhe të sigurtë.**

Lefteri Kushta

Ekspert Kontabël I Regjistruar

Lic. 58 date 31.01.2000

Tiranë më 15.10. 2015

**SHENIME**  
**MBI DEKLARATAT FINANCIARE**  
**PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET LOKALE 2015**

**I. Të përgjithshme**

**Baza ligjore e kryerjes së këtij misioni është:**

- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10.02.2011;
- Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe kryesisht SNA 800;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë Socialiste të Shqipërisë.

**Të përgjithshme mbi Subjektin Zgjedhor**

Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton e rregjistruar me urdhër nr.36/1, datë 15.08.1991, të Ministrit të Drejtësisë. Sipas këtij vendimi, është miratuar krijimi i Partisë, “Partia Socialiste”, me initiale “PS” ose “PSSH”. Kryetar i saj, është zoti EDI RAMA.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 8580 , dt.17.02.2000 “Per Partite Politike”, Ligjit nr. 8788, dt. 07.05.2001 “Per Organizatat Jofitimpruese” , Ligjit 8779, dt. 07.05.2001 “Per Regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese “, nga Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Selia e parties eshte ne rrugen “Sheshi Austria”, Tirane.

**Organizimi dhe drejtimi**

Organet drejtuese ne udheheqjen qendrore të PSSH janë:

- Kongresi i Partisë;
- Asambleja Kombëtare;
- Kryesia e partisë;
- Kryetari i Partisë.

Gjithashtu, në statut janë përcaktuar edhe organet drejtuese në rrethe:

- Këshilli Koordinuar i Partisë në Qark;

- Asambleja Socialiste e Rrethit;
- Kryetari i Partisë së Rrethit;
- Asambleja Socialiste e Bashkisë
- Kryetari i Partisë i AS të Bashkisë.

### **Burimet financiare të Partisë janë:**

- Të ardhurat nga kuazitacionet;
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike;
- Ndihamat dhe dhurata e anëtarësisë dhe të përkrahësve të PSSH sipas ligjit për partitë politike.
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

## **II. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL**

### **II.1 Mënyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare**

Gjendja u përgatit me qëllimin për të raportuar tek Komisioni Qëndror i Zgjedhor, për fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera. Kontabiliteti është ndërtuar mbi bazën e parimeve të konstatimit. Sipas kësaj mënyre, fondet e përfituara në të holla, janë regjistruar në momentin e arkëtimit të tyre dhe fondet e përfituara në natyrë dhe shërbimet në momentin e kryerjes, duke i konvertuar në lekë me çmimin e tregut dhe shpenzimet janë pasqyruar në momentin e konstatimit të tyre kur janë kryer. Administrimi i fondeve të përfituara dhe shpenzimet e kryera, janë të përqëndruara, në Seline e Partisë Socialiste, në Qendër.

- Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (SKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*” dhe Planin Uni Kontabël, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- *Rregullat për vlerësimin e kërkesave për arkëtim dhe të detyrimeve.* Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale, të lëshuara nga klientët apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentave origjinale kontabël.
- *Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve.* Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjet e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse në bankë, në lekë. U kontrolluan veprimet e kryera në

arkë dhe bankë, e u konstatuan se veprimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas rregullave kontabël.

- Të *ardhurat* regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga donatorët dhe përdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.
- *Monedha e raportuar*. Si monedhë bazë raportimi është përdorur monedha kombëtare, Lekë. Fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera, janë mbartur në dokumentacionin fillestar në monedhat All, USD dhe Euro . Gjendjet janë përgatitur në Lekë. Fondet dhe shpenzimet e emëtuara në monedha të huaja, janë konvertuar në Lekë, bazuar në kursin e këmbim të datës që është kryer transaksioni, dhe donacionet në natyrë janë vlerësuar në Lekë, me çmimin e tregut në momentin e përfitimit.

## II.2 Organizimi i Kontabilitetit

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Partia ka ndërtuar një plan të llogarive vetjake, në përputhje të plotë me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshëm kryhet nga dega e financës. Kontabiliteti mbahet në programin ALPHA. Kontrolli i brendshëm kryhet nga dega e finances.

Kontabiliteti është i ndërtuar mbi bazën e parimeve të konstatimit. Sipas kësaj mënyre fondet e përfituara në të holla janë regjistruar në momentin e arketimit të tyre dhe fondet e përfituara në formë materiale dhe shërbimi në momentin e kryerjes dhe shpenzimet janë pasqyruar në momentin e konstatimit të tyre kur janë kryer.

Mbi bazën e këtyre parimeve të kontabilitetit, në llogaritë kontabile e në pasqyrat financiare të Partisë Socialiste, janë evidentuar e deklaruar si shpenzime për fushatën zgjedhore edhe faturat e pranuar, por të papaguara, ndaj furnitorëve të ndryshëm, për shërbimet e përfituara gjatë fushatës elektorale. Këto veprime, janë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, të dala në zbatim të tij.

Në këtë kuadër konceptual të të ardhurave dhe shpenzimeve, auditimi u shtri dhe mori në konsideratë dhe ngjarje e fakte ekonomike dhe financiare, që i takojnë fushatës zgjedhore të 21 qershorit 2015, pavarësisht se ato kanë ndodhur edhe në periudha jashtë kufirit zyrtar të kësaj fushate.

Auditimi i situatës financiare të fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste, mori për bazë raportet financiare, regjistrat kontabile si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili na bëri të mundur, krijimin e bazës së opinionit të Audituesit të Pavarur, përangazhime auditimi për qëllime të veçata, në përputhje me SNA 800, siç shpjegohet në vijim.

Administrimi I fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera eshte bere nga Selia Qendrore. Deget financiare ne rrethe kane derdhur prane selise qendrore fondet e destinuar per kete qellim (kuotat e antarsise ) dhe shpqnzimet jane kryer dhe likujduar nga selia qendrore.

Megjithëse fushata e zgjedhjeve për zgjedhjet lokale 2015, ka filluar me datë 21.05.2015 dhe përfundoi me datën 21.06.2015, aktiviteti në shërbim të kësaj fushate shtrihet në një periudhë më të gjatë se sa ky kufi zyrtar.

Për Partinë Socialiste periudha e financiare e fushatës zgjedhore, shtrihet kryesisht në muajt Mars-qershor 2015, e cila vazhdon dhe me pas, duke mos përfunduar as në muaji tetor 2015 kur kryhet auditimi, pasi priten ngjarje të mëvonshme, për sigurimin e të ardhurave të tjera për të paguar shumat faturash të pranuar për shërbime të kryera nga disa media, në shërbim të fushatës elektorale të Partisë Socialiste.

### III. Të ardhurat

Bazuar në auditimin e kryer rezulton se të ardhurat për fushatën elektrale të Partisë Socialiste, sipas burimit të financimit të tyre, klasifikohen si vijon:

| PASQYRA E TË ARDHURAVE TË PARTISË SOCIALISTE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE 21 MAJ-21 QERSHOR 2015 |                                      |                            |                 |           |                 |
|--|--------------------------------------|----------------------------|-----------------|-----------|-----------------|
| Nr.  | Burimet e financimit                 | Sipas raportimit financiar | Sipas auditimit | Diferenca | Pasha specifike |
|  |                                      | Lekë                       | Lekë            | Lekë      | %               |
| 1  | 2                                    | 3                          | 4               | 5         | 6               |
| 1  | Nga buxheti I shtetit                | 18.120.554                 | 18.120.554      | -         | 19.55%          |
| 2  | Nga fondet Vjetore                   | 21.967.090                 | 21.967.090      |           | 23.70%          |
| 3  | Nga fondet e vetë Partisë Socialiste | 34.125.750                 | 34.125.750      | -         | 36.81%          |
| 4  | Nga donatorët (sponsorizime)         | 18.490.000                 | 18.490.000      | -         | 19.94%          |
|  | -Me bankë                            | 16.940.000                 | 18.490.000      | -         |                 |
|  | -Me arkë                             | 1.550.000                  | 1.550.000       | -         |                 |
|  | -në natyrë                           | -                          | -               | -         |                 |
|  | Gjithsej të ardhura                  | 92.703.394                 | 92.703.394      | -         | 100%            |

Nga auditimi rezultoi se të ardhurat e siguruar nga Partia Socialiste për të përballuar fushatën për zgjedhjet vendore 2015, janë deklaruar gjithsej 92.703.394 lekë. Këto të ardhura janë krijuar nga tre burime të ligjshme, konkretisht:

- 1. Financime nga buxheti i shtetit për fushatën elektorale 18.120.554 Lekë ose 19.55 % të totalit të fondeve të përdorura për fushatën e zgjedhjeve të cilat janë arkëtuar në**



qershor 2015, në degën e bankës Credins, në llogarinë me nr. 00288405 të çelur posaçërisht nga Partia Socialiste, për këtë fushatë zgjedhore.

**2. Nga Fondet vjetore 21.967.090 leke ose 23.7%**

Nga kontrolli i fluksit të parasë rezulton se Partia Socialiste perpara fillimit të fushatës të vitit 2015 ka trashëguar në llogaritë bankare të saj në usd 126.630, të cilat janë përdorur në datat 16/3/2015 dhe 09/04/2015 për pagesën e Konsulentit të fushatës, ARTHUR FINKELSTEIN ASSOCIATER 80.050 usd dhe pagesën e materielave zgjedhore BEIJING HULIAN MACHINERY ELEKTRONICS CO LTD – Kinë në datat 01/04/2015 në shumën 46.400 usd dhe për komisionet bankare 172.42 usd.

**3. Fondet e vetë Partisë Socialiste 34.125.750 Lekë, përbëjnë pjesën kryesore të burimit të fushatës elektorale duke zënë 36.81 % të të ardhurave gjithsej dhe të cilat përbehen nga “**

- Kuota të antarsisë në leke 11.500.000
- Kuota të antarsisë në usd 175.000 usd ose 22.625.750 (kursi mesatar 129.29 )

**4. Sponsorizime (donacione nga shtetas shqiptarë) 18.490.000 Lekë, përbëjnë një pjesë të burimit të fushatës elektorale duke zënë 19.94 % të të ardhurave gjithsej dhe të cilat përbehen nga “**

- Me banka 16.940.000 leke
- Me arke 1.550.000 leke

Sponsorizimet janë kryer në llogarinë bankare të depozituar pranë KQZ me nr. 00288405 pranë Bankës Credins nga 20 dhurues, shtetas shqiptarë, të cilët kanë sponsorizuar me shumën parash deri në 1.000.000.00 lekë për çdo rast për fushatën elektorale, si vijon:

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Lekë      | Dollar | Euro | Data e dhurimit | Llogaritë ku janë derdhur |
|-----|------------------|-----------|--------|------|-----------------|---------------------------|
| 1   | Dritan Dalipi    | 1.000.000 | -      | -    | 16/06/2015      | Credins nr 00288405       |
| 2   | Indrit Tafani    | 1.000.000 | -      | -    | 19/06/2015      | Credins nr 00288405       |
| 3   | Luan Sturce      | 1.000.000 | -      | -    | 19/06/2015      | Credins nr 00288405       |
| 4   | Gerta Lubonja    | 900.000   | -      | -    | 19/06/2015      | Credins nr 00288405       |
| 5   | Frangë Dorzi     | 900.000   | -      | -    | 19/06/2015      | Credins nr 00288405       |
| 6   | Enkela Bamova    | 900.000   | -      | -    | 19/06/2015      | Credins nr 00288405       |
| 7   | Julinda Kolli    | 900.000   | -      | -    | 19/06/2015      | Credins nr 00288405       |

|           |                                 |                   |          |          |            |                     |    |
|-----------|---------------------------------|-------------------|----------|----------|------------|---------------------|----|
| 8         | Dorian Hila                     | 900.000           | -        | -        | 19/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 9         | Ermal Tahiri                    | 300.000           | -        | -        | 19/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 10        | Bukuroshe Ila                   | 240.000           | -        | -        | 19/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 11        | Klevi Bako                      | 900.000           | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 12        | Florian Pullazi                 | 1.000.000         | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 13        | Alketa Hila                     | 1.000.000         | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 14        | Fatjon Shehu                    | 1.000.000         | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 15        | Uran Mati                       | 1.000.000         | -        | -        | 20/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 16        | Etleva Dobi                     | 1.000.000         | -        | -        | 20/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 17        | Zhaneta Hoxha                   | 1.000.000         | -        | -        | 20/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 18        | Adrian Jance                    | 1.000.000         | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 19        | Andi LLazi                      | 400.000           | -        | -        | 19/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 20        | Margarita Hysi                  | 600.000           | -        | -        | 19/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| <b>I</b>  | <b>TOTALI</b>                   | <b>16.940.000</b> | <b>-</b> | <b>-</b> |            |                     |    |
|           |                                 |                   |          |          |            |                     |    |
|           | <b>SPONSORIZIME<br/>ME ARKE</b> |                   |          |          |            |                     |    |
| 1         | Kristaq Tile                    | 300.000           | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 2         | Gezim Kopo                      | 300.000           | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 3         | Jani Cipi                       | 200.000           | -        | -        | 19/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 4         | Fatmir Muca                     | 250.000           | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| 5         | Vladimir Konomi                 | 500.000           | -        | -        | 16/06/2015 | Credins<br>00288405 | nr |
| <b>II</b> | <b>TOTALI</b>                   | <b>1.550.000</b>  |          |          |            |                     |    |
|           | <b>Totali I + II</b>            | <b>18.490.000</b> |          |          |            |                     |    |

Nga verifikimi rezultoi se të gjithë dhuruesit kanë nënshkruar deklaratën e mospasjes konflikt interesi, në përputhje me nenin nr.89, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Të gjithë këta dhurues, janë evidentuar dhe deklaruar në regjistrin e posaçëm, të mbajtur sipas formatit të miratuar me vendim nr.266, datë 01.06.2009 nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Fondet prej 1.550.000 lekë, të dhuruara nga anëtarësia janë dokumentuar hyrje në arkën e parties dhe pastaj janë derdhur ne banke me emra personale.

Në të gjitha rastet, dhuruesit kanë respektuar kërkesën ligjore të Kodit Zgjedhor, sipas të cilës, dhurata nuk mund të jetë më shumë se 1.000.000.00 lekë për çdo rast. Po ashtu, nga verifikimi rezultoi, se të gjitha këto dhurime janë kryer nëpërmjet llogarisë bankare nr. 00288405, llogari e posaçme e çelur për fushatën elektorale të 21 qershorit 2015, nga Partia Socialiste pranë Bankës Credins , si dhe janë deklaruar brënda afatit ligjor prane KQZ.

Te gjithë sponsorizuesit kane nënshkruar deklaraten e mosperfitimit te fondeve publike ne perputhje me Kodin Zgjedhor.

Lidhur me sponsorizimet në natyrë, nuk ka patur te tilla.

#### IV. Shpenzimet

Nga verifikimet e kryera, rezultoi se shpenzimet për fushatën elektorale të Partisë Socialiste, të grupuara sipas natyrës së tyre, janë si vijon:

| Nr. | Grupet e shpenzimeve               | Shuma në lekë            |                   |           |
|-----|------------------------------------|--------------------------|-------------------|-----------|
|     |                                    | Sipas raportit financiar | Sipas auditimit   | Diferenca |
| a   | Shpenzime të paguara               |                          |                   |           |
| 1.  | Reklama, spote televizive          | 26.837.325               | 26.837.325        | -         |
| 2.  | Eventet e hapjes mbylljes fushates | 16.185.816               | 16.185.816        | -         |
| 3.  | Materiale zgjedhore                | 33.884.062               | 33.884.062        | -         |
| 4.  | Karburant                          | 3.098.000                | 3.098.000         | -         |
| 5.  | Qera makinash                      | 497.328                  | 497.328           | -         |
| 6.  | Konsulenca                         | 10.495.490               | 10.495.490        | -         |
| 7.  | Kancelari, fotokopje, letër etj.   | 168.402                  | 168.402           | -         |
| 8.  | Kërkesë padi                       | 73.000                   | 73.000            | -         |
| 9.  | Internet                           | 300.000                  | 300.000           | -         |
| 10. | Të ndryshme                        | 194.895                  | 194.895           | -         |
|     | <b>Shuma e shpenzimeve</b>         | <b>91.734.318</b>        | <b>91.734.318</b> | -         |
| b.  | Shpenzime të papaguara             |                          |                   |           |
| 1.  | Reklama radio televizive           | 17.756.985               | 17.756.985        |           |

|    |   |                    |                    |  |
|----|---|--------------------|--------------------|--|
| 2. | Shërbime Digi Print                     | 208.355            | 208.355            |  |
|    | <b>Shuma e shpenzimeve të papaguara</b> | <b>17.965.340</b>  | <b>17.965.340</b>  |  |
|    | <b>Gjithsej shpenzime te kryera</b>     | <b>109.699.658</b> | <b>109.699.658</b> |  |

Shpenzimet e fushatë së Partisë Socialiste për zgjedhjet e 21 qershorit 2015, janë deklaruar gjithsej 109.699.658 lekë, nga të cilat deri në datën e hartimit të këtij raporti, janë paguar 91.734.318 lekë dhe diferenca 17.965.340 lekë, ndonëse është njohur si shpenzim, nuk rezulton ë jetë paguar brenda kësaj periudhe.

Nga verifikimet tona rezulton se këto shpenzime nuk e kalojnë kufirin ligjor të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Koha e kryerjes së shpenzimeve në përgjithësi përputhet me afatin zyrtar të fushatës zgjedhore, por një pjesë e tyre janë bërë para fillimit zyrtar të fushatës dhe një pjesë tjetër pas datës 21 qershor 2015, në varësi nga koha e pranimit apo likuidimit të faturave, për shërbimet e përfituara. Deklarimi i shpenzimeve është bërë në mënyrë korrekte.

Nje pjese e ketyre shpenzimeve për shkak të mungesës së fondeve financiare, kanë mbetur pa u paguar Keto shpenzime te papaguara jane njohur si detyrime dhe perbehen nga detyrime kryesisht ndaj mediave, të cilat kanë kryer shërbime reklamash gjatë fushatës zgjedhore. Këto shërbime, të gjitha janë të dokumentuara, të vërtetuara me fatura tatimore me tvsh, e konkretisht:

| Nr. | Subjekti          | Fatura        |            |                   |
|-----|-------------------|---------------|------------|-------------------|
|     |                   | Numri fatures | Datë       | Shuma lekë        |
| 1.  | Top Channel       | Fat nr. 799   | 19/06/2015 | 6.683.485         |
| 2.  | Top Albania Radio | Fat nr. 134   | 19/06/2015 | 500.000           |
| 3.  | Ora Sha           | Fat nr. 171   | 18/06/2015 | 10.573.500        |
| 4.  | Dixhi Print       | Fat nr. 281   | 30/06/2015 | 208.355           |
|     | <b>Shuma</b>      |               |            | <b>17.965.340</b> |

Në tërësi, shpenzimet janë të dokumentuara me fatura tatimore apo mandate arkëtime të institucioneve buxhetore, që nuk janë subjekte tatimore, si dhe janë të evidentuara në pajtim me rregullat dhe standartet kontabile që zbatohen në Shqipëri.

Bazuar në grupimin e shpenzimeve të deklaruar nga Partia Socialiste, me riklasifikimn e tyre sipas natyrës, grupet e shpenzimeve sa vijon rezultojnë:

Ndryshimet në grupet e veçanta të shpenzimeve, janë pa efekte materiale, në tërësinë e tyre dhe përfundimisht, totali i shpenzimeve sipas auditimit është i barabartë me atë që ka deklaruar Partia Socialiste. Shpenzimet e klasifikuara nga ana jonë, janë si vijon:

1. **Shpenzimet për reklama televizive**, në shumën 44.594.295 lekë, zënë pjesën kryesore ose 40.65 % të tyre. Nga këto, 26.837.325 leke janë likuiduar, ndërsa diferenca 17.756.985 lekë, ka mbetur pa u paguar për mungesë fondesh, duke u evidentuar e deklaruar në Kontabilitetin e Partisë, si Detyrime të Kërkueshme nga Furnitorët, që do të shlyhen kur të sigurohen burime financimi.

Të detajuara sipas subjekteve mediatike këto shpenzime paraqiten si me poshte :

| <b>PASQYRA E SHPENZIMEVE PËR REKLAMA</b> |   |                   |                     |                            |
|--|---|-------------------|---------------------|----------------------------|
| <b>Nr.</b>                               | <b>Emërtimi</b>                             | <b>Likuiduar</b>  | <b>Pa likuiduar</b> | <b>Totali I shpenzimit</b> |
| 1.                                       | Top Media (Top Channel, Top Albania Radio ) | 17.276.295        | 7.183.485           | 24.459.780                 |
| 2.                                       | Focus Media(News 24)                        | 4.537.830         | -                   | 4.537.830                  |
| 3.                                       | ORA Sha (Ora News)                          | 5.023.200         | 10.573.500          | 15.596.685                 |
|  | <b>Shuma</b>                                | <b>26.837.325</b> | <b>17.756.985</b>   | <b>44.594.295</b>          |

Këto shpenzime janë kryer në bazë të kontratave të lidhura midis palëve dhe vërtetohen me fatura të rregullta tatimore. Nga verifikimi rezultoi se të gjitha faturat e likuiduara, që i përkasin këtij grupi shpenzimesh, janë paguar vetëm nëpërmjet llogarive bankare.

2. **Shpenzime për materiale publicitare dhe materiale të tjera**, në shumën 33.564.062 lekë, zënë 30.6 % të totalit të shpenzimeve gjithsej. Në këtë grup shpenzimesh janë deklaruar shpenzimet për blerje flamujsh dhe bluaza nga Kina për 27.894.812 leke, shpenzimet për taksën doganore në shumën 5.576.345 leke dhe shpenzimet për taks magazinimi për 92.905 leke. Nga verifikimi rezultoi se këto shpenzime vërtetohen nga deklarata e importit dhe fatura e magazinimit dhe janë paguar nëpërmjet pranë bankës Credins.

3. **Shpenzime për eventet e hapjes dhe mbylljes fushates në shumën 16.394.171 lekë** të cilat të detajuara paraqiten :

|   |                |
|---|----------------|
| - Sherbime Fonie (Pro Saund shpk)         | 4.029.920 leke |
| - Sherbime nga Dixhi Print shpk           | 5.280.251 leke |
| -Sherbim Satelitor (Leonard Lamaj PFizik) | 1.680.000 leke |
| -Moket (ARAL shpk)                        | 2.002.500 leke |
| -Sherbim dekori (Elit Clas)               | 261.500 leke   |

-Sherbim regjije (A. Llanaj Person fizik) 3.140.000 leke

Totali 16.394.171 leke

Keto shpenzime rezultojne të jenë paguar vetëm 16.185.816 lekë, nëpërmjet bankës ndërsa shuma 208.355 lekë janë shpenzime të papaguara për mungesë fondesh duke u evidentuar e deklaruar në Kontabilitetin e Partisë si detyrime që do të shlyhen kur të sigurohen këto burime.

| Nr. | Emërtimi     | Likuiduar | Pa likuiduar | Totali I shpenzimit |
|-----|--------------|-----------|--------------|---------------------|
| 1.  | Dixhi Print  | 5.071.896 | 208.355      | 5.280.251           |
|     | <b>Shuma</b> | 5.071.896 | 208.355      | 5.280.251           |

**4. Shpenzime për konsulenca ne shumen 10.495.490 lekë** , janë të dokumentuara me fatura sherbimi nga ARTHUR FINKELSTEIN ASSOCIATER dhe te likujduara nepermjet bankes Credins ne Shumen 80.050 usd.

**5. Shpenzime për karburant ne Shumen 3.098.000 lekë** , janë të dokumentuara me fatura blerje tatimorë, të lëshuara nga “KASTRATI” sha. PAGESA e tyre është bërë nëpërmjet llogarive bankare.

**6. Shpenzime për internet ne shumen 300.000 lekë** te paguara pranë degës së bankës Credins.

**7. Shpenzime për kancelari ne Shumen 168.402 lekë**, përbëhen kryesisht nga shpenzime për letër, bojë printer, fotokopje të cilat janë paguar nëpërmjet arkës. Nga verifikimi rezultoi se ato janë të dokumentuara me fatura të rregullta tatimore.

**8. Shpenzime për makina me qera ne Shumen 497.328 lekë**, te cilat janë vërtetuar me fatura tatimore dhe pagesa nga banka.

**9. Shpenzime për kërkesë padi ne Shumen 73.000 lekë**, janë vërtetuar me mandate arkëtimet e lëshuara nga Gjykata e Apelit për të njëjtën shumë.

**10. Shpenzime të ndryshme ne Shumen 194.895 lekë**, ku përfshihen shpenzime për blerje kafe, kompjuter, komisione bankare. Nga verifikimi rezultoi se edhe këto shpenzime janë të dokumentuara me fatura tatimore dhe janë paguar nëpërmjet llogarive bankare.

Ne total shpenzimet e kryera dhe te likujduara paraqiten si me poshte :

|  |                 |
|--|-----------------|
| - Banka credins Llog e fushates 288405 ne Shumen       | 47.284.565 leke |
| - Banka credins usd ne nr. 124755 (llog usd) ne Shumen | 39.404.235 leke |
| - Banka credins leke ne nr. 112879 ne Shumen           | 4.703.311 leke  |
| - Arka ne Shumen                                       | 342.207 leke    |
| Totali   | 91.734.318 leke |

Përfundimisht, bazuar në auditimin e kryer, sipas Standartit Ndërkombëtar të Auditimit nr. 800 ( për qëllime të veçanta) me siguri të arsyeshme, në Raportin e Audituesit të Pavarur kemi shprehur Opinionin se Pasqyra Financiare e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të Fushatës Elektorale të Partisë Socialiste, jep një pamje të vërtetë e të sinqertë të të Ardhurave të Realizuara dhe të Shpenzimeve të kryera gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale te Vitit 2015.

Lefteri KUSHTA

Ekspert Kontabël I Regjistruar Lic. 58

Tiranë më 15.10. 2015